



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës • Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 606/25 Dt. 06.11.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008) nenit 1 paragrafi 2, nenit 3 paragrafi 2 dhe nenit 14 paragrafi 1 lidhur me nenin 27 paragrafi 2 i Rregullores Komunale nr. 001-011-201, datë 03.01.2024, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Transfereve dhe Granteve dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës 01-400 nr. 140507, të datës 20.10.2025, të Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale në Prizren, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare

1. Miratohet kërkesa 01-400 nr. 140507, të datës 20.10.2025, të Shoqatës Sindikale të Administratës Komunale në Prizren, për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit për Agron Ukimeri, zyrtar publik komunal në Drejtorinë e Administratës së Komunës së Prizrenit, i cili është lënduar në vendin e punës, kështu që, për këtë qëllim dhe në emër të mbulimit të pjesshëm të shpenzimeve të mjekimit (trajtimit mjekësor) lejohen mjetet financiare në shumën prej 500.00 € (pesëqind euro).
2. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës–pozicioni i subvencioneve dhe transfereve i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Obligohet Drejtoria për Ekonomi dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj



- Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
 - Drejtorisë së Shëndetësisë,
 - ShSAK,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.